VENDIM
Nr. 50, datë 30.3.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË KREDISË NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të neneve 57, 58, 61, 68 dhe 70, pika 5, shkronja "a", të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja", miratuar me vendimin nr. 62, datë 14.9.2011, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja "i" e pikës 2, të nenit 4 dhe pika 4 e nenit 14, shfuqizohen.

b) Neni 17 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Emërtimi i nenit ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"Fshirja nga bilanci e kredive të humbura";

ii) Togfjalëshi "fshirja e kredive" bëhet kudo "fshirja e kredive nga bilanci";

iii) Paragrafi 4 i nenit ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"4. Dosjet e kredive të fshira nga bilanci, ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj nga Këshilli Drejtues i bankës. Banka, pavarësisht fshirjes së kredive nga bilanci, vazhdon të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e këtyre kredive."

c) Pas nenit 19, shtohet neni 19/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Neni 19/1

Kërkesa të veçanta për trajtimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të përftuara nga banka kundrejt shlyerjes së kredive

1. Bankat hartojnë strategji dhe plane të brendshme, si dhe krijojnë strukturat e përshtatshme për shitjen e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të përftuara kundrejt shlyerjes së kredive të dhëna.

2. Bankat, në rastet kur nuk mund të shesin pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të përftuara kundrejt shlyerjes së kredive brenda vitit të parë të përfitimit të tyre, krijojnë fonde rezervë për mbulimin e humbjeve.

3. Për pasuritë e paluajtshme, fondet rezervë krijohen brenda një periudhe jo më të gjatë se 7 (shtatë) vite nga data e përftimit të tyre (marrjes së tyre në pronësi në përfundim të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm për kreditë e pashlyera) dhe në nivelin jo më pak se norma në përqindje e vlerës kontabël të këtyre pasurive, sipas tabelës së mëposhtme:

Viti i parë	5%
Viti i dytë	15%
Viti i tretë	30%
Viti i katërt	45%
Viti i pestë	60%
Viti i gjashtë	80%
Viti i shtatë	100%

4. Për pasuritë e luajtshme, bankat krijojnë fonde rezervë në nivelin jo më pak se 100% të vlerës kontabël të pasurisë së luajtshme, në rastet kur nuk mund t'i shesin këto pasuri brenda një viti nga data e përftimit të tyre.

5. Bankat, për pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të përftuara deri në muajin dhjetor të vitit 2015, për efekt të llogaritjes së fondeve rezervë, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, do të

konsiderojnë si vit të parë vitin 2016.".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 1.12.2016.

KRYETARI
Gent Sejko